

20232664607

**LIGJI I HUAMARRJES SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT ME HUA  
NGA BANKA KREDITORE PËR RINDËRTIM - KfV SIPAS MARRËVESHJES SË  
HUAS BAZUAR NË POLITIKAT E MAQEDONISË SË VERIUT**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut i detyrohet Bankës Kreditore për Rindërtim - KfV me hua bazuar në politikat e Maqedonisë së Veriut në vlerë prej 90.000.000 eurove.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 të këtij ligji përcaktohen me Marrëveshjen e huas, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Kreditore për Rindërtim – KfV.

Në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Marrëveshjen e huas të paragrafit (1) të këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 3

Huaja e nenit 1 të këtij ligji do të tërhiqet në një transhe.

Afati për shlyerjen e huas së nenit 1 të këtij ligji është 12 vjet e pesë muaj, duke përfshirë edhe periudhën grejs prej tre vjetësh.

Norma e interesit për transhenë e huas do të përcaktohet pas tërheqjes së saj.

Gjatë tërheqjes së transhesë, do të përlllogaritet normë mesatare e ponderuar e interesit dhe ajo do të zbatohet mbi vlerën e tërhequr të huas.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Kreditore për Rindërtim - KfV provizion të njëhershëm në vlerë prej 0.5% të vlerë së huas.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Kreditore për Rindërtim - KfV provizion të njëhershëm në vlerë prej 0.25% të pjesës së patërhequr të huas.

Provizioni i paragrafit (6) të këtij neni do paguhet në nivel gjysmëvjetor.

Neni 4

Mjetet e huas së nenit 1 të këtij ligji, do të shfrytëzohen për përkrahje të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 5

Republika e Maqedonisë së Veriut do ta paguajë huan e nenit 1 të këtij ligji nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.